L I G J
Nr.9036, datë 27.3.2003

PËR RATIFIKIMIN E "KONVENTËS NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË MOLDAVISË PËR SHMANGIEN E TAKSIMIT TË DYFISHTË DHE PËR PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL PËR TATIMET MBI TË ARDHURAT DHE MBI KAPITALIN"

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Konventa ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Moldavisë për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe për parandalimin e evazionit fiskal për tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.3787, datë 22.4.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

KONVENTË
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MOLDAVISË PËR SHMANGIEN E TAKSIMIT TË DYFISHTË DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL, LIDHUR ME TATIMET MBI TË ARDHURAT DHE MBI KAPITALIN

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Moldavisë:

duke dëshiruar të përfundojnë një Konventë për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin,

kanë rënë dakord për sa vijon:

Neni 1
Personat që mbulon Konventa

Kjo Konventë do të zbatohet ndaj personave që janë rezidentë të njërit ose të të dy Shteteve Kontraktuese.

Neni 2
Tatimet që mbulon Konventa

1. Kjo Konventë do të zbatohet për tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin të vendosura në emër të një Shteti Kontraktues ose nga njësitë e tij administrativo-territoriale apo autoritetet lokale, pavarësisht nga mënyra e vjeljes së tyre.

2. Do të konsiderohen tatime mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin të gjitha tatimet e vendosura mbi të ardhurat totale, mbi kapitalin në total ose mbi elemente të të ardhurave ose të kapitalit, përfshirë tatimet mbi fitimet nga tjetërsimi i pasurive të luajtshme ose të paluajtshme, tatimet mbi shumën totale të pagave ose shpërblimeve të dhëna nga sipërmarrjet, si edhe tatimet mbi rivlerësimin e kapitalit.

3. Tatimet ekzistuese, ndaj të cilave do të zbatohet Konventa, janë në veçanti:

a) Në Shqipëri:

i) tatimi mbi të ardhurat (përfshirë tatimin mbi fitimin e personave juridikë dhe tatimin mbi të ardhurat personale);

ii) tatimi mbi aktivitetet e biznesit të vogël;

iii) tatimi mbi pasurinë;

(në vijim do t'u referohemi si "tatimet shqiptare")

b) në Moldavi:

i) tatimi mbi të ardhurat;

ii) tatimi mbi pasurinë e paluajtshme;

(në vijim do t'u referohemi si "tatimet moldave")

4. Konventa do të zbatohet gjithashtu për tatime të njëllojta ose tepër të ngjashme, të cilat do të vendosen pas datës së nënshkrimit të Konventës, si shtojcë ose në vend të tatimeve ekzistuese. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do t'i bëjnë të ditur njëri-tjetrit çdo ndryshim të rëndësishëm që do të bëhet në ligjet e tyre përkatëse tatimore.

Neni 3

Përcaktime të përgjithshme

1. Për qëllimet e kësaj Konvente, përderisa përmbajtja të mos e kërkojë ndryshe:

a) termat "një Shtet Kontraktues" dhe "Shteti tjetër Kontraktues" nënkuptojnë Shqipërinë ose Moldavinë, siç e kërkon përmbajtja;

b) termi "Shqipëria" nënkupton Republikën e Shqipërisë dhe, kur përdoret në sensin gjeografik, nënkupton territorin e Republikës së Shqipërisë, përfshirë ujërat territoriale dhe hapësirën ajrore mbi to, si edhe çdo zonë përtej ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë, e cila, në bazë të ligjeve të saj dhe në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, është një zonë, brenda së cilës Republika e Shqipërisë mund të ushtrojë të drejta lidhur me tabanin detar, nëntokën dhe burimet e tyre natyrore;

c) termi "Moldavia" nënkupton Republikën e Moldavisë dhe, kur përdoret në sensin gjeografik, nënkupton territorin e saj brenda kufijve të saj, përfshirë tokën, nëntokën, hapësirën ujore dhe ajrore mbi tokë dhe ujë, mbi të cilën Republika e Moldavisë ushtron juridiksionin dhe sovranitetin absolut ekskluziv, në përputhje me legjislacionin e saj të brendshëm dhe të drejtën ndërkombëtare;

d) termi "person" përfshin një individ, një shoqëri dhe çdo grup tjetër personash;

e) termi "shoqëri" nënkupton çdo ent ligjor që trajtohet si person juridik për qëllime tatimore;

f) termat "sipërmarrje e një Shteti Kontraktues" dhe "sipërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues" nënkuptojnë respektivisht një sipërmarrje të ushtruar nga një rezident i një Shteti Kontraktues dhe një sipërmarrje të ushtruar nga një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues;

g) termi "nënshtetas" nënkupton:

i) çdo individ që zotëron nënshtetësinë e një Shteti Kontraktues;

ii) çdo person juridik, ortakëri ose shoqatë që gëzojnë statusin si të tillë në përputhje me ligjet në fuqi në një Shtet Kontraktues;

h) termi "trafik ndërkombëtar" nënkupton çdo transport me anije ose një avion, që kryhet nga një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues, përveç kur anija ose avioni vepron vetëm ndërmjet vendeve brenda Shtetit tjetër Kontraktues;

i) termi "autoritet kompetent" nënkupton:

i) në Shqipëri, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;

ii) në Moldavi, Ministrinë e Financave ose përfaqësuesin e autorizuar prej saj.

2. Përsa i përket zbatimit të kësaj Konvente në çdo kohë nga një Shtet Kontraktues, çdo term i papërcaktuar këtu, përderisa përmbajtja të mos e kërkojë ndryshe, do të ketë kuptimin që i është dhënë sipas legjislacionit të atij shteti lidhur me tatimet, ndaj të cilave zbatohet Konventa. Çdo kuptim sipas legjislacionit tatimor të atij shteti ka përparësi ndaj kuptimit të dhënë të atij termi sipas ligjeve të atij shteti.

Neni 4

Rezidenca

1. Për qëllime të kësaj Konvente, termi “rezident i një Shteti Kontraktues” nënkupton çdo person që, sipas ligjeve të atij shteti, është subjekt i tatimeve atje për shkak të vendbanimit, rezidencës, vendit të drejtimit, vendit të regjistrimit apo çdo kriteri tjetër të një natyre të ngjashme, dhe gjithashtu përfshin atë shtet, njësitë administrativo-territoriale ose autoritetet lokale atje. Por, sidoqoftë, ky term nuk përfshin personat që i nënshtrohen tatimit në atë shtet vetëm për të ardhura nga burime në atë shtet apo kapitali i vendosur aty.

2. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1 një individ është rezident i të dy Shteteve Kontraktuese, atëherë statusi i tij do të përcaktohet si vijon:

a) Ai do të konsiderohet rezident vetëm i shtetit në të cilin ai ka bërë një banesë të përhershme në dispozicion të tij. Në qoftë se ai ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij në të dy shtetet, ai do të konsiderohet rezident vetëm i shtetit, me të cilin interesat e tij personale dhe ekonomike janë të lidhura më ngushtë (qendra e interesave jetike).

b) Në qoftë se shteti, në të cilin ai ka qendrën e interesave jetike, nuk mund të përcaktohet ose në qoftë se ai nuk ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij në asnjërin Shtet, ai do të konsiderohet rezident vetëm i shtetit, në të cilin ai qëndron zakonisht.

c) Në qoftë se ai qëndron rregullisht në të dy shtetet ose në asnjërin prej tyre, ai do të konsiderohet rezident vetëm i shtetit, nënshtetas i të cilit ai është.

d) Në qoftë se ai është nënshtetas i të dy shteteve ose i asnjërit prej tyre, autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do ta zgjidhin këtë çështje me mirëkuptim reciprok.

3. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1 një person joindivid është rezident i të dy Shteteve Kontraktuese, atëherë ai do të konsiderohet rezident vetëm i shtetit në të cilin është vendosur qendra e tij e drejtimit efektiv.

Neni 5
Seli e përhershme

1. Për qëllime të kësaj Konvente, termi “seli e përhershme” nënkupton një vend fiks biznesi, nëpërmjet të cilit ushtrohet tërësisht ose pjesërisht biznesi i një sipërmarrjeje.

2. Termi “seli e përhershme” përfshin në veçanti:

a) një vend drejtimi;

b) një degë;

c) një zyrë;

d) një fabrikë;

e) një punishte,

f) një minierë, një pus nafte ose gazi, një gurore ose çdo vend tjetër për shfrytëzimin e burimeve natyrore.

3. Termi “seli e përhershme” do të përfshijë gjithashtu:

a) një shesh ndërtimi, një konstruksion, projektmontimi ose instalimi, ose projekte mbikëqyrjeje të lidhura me to, por vetëm kur një shesh i tillë, projekte ose aktivitete vazhdojnë për një periudhë prej më shumë se nëntë muaj brenda çdo periudhe dymbëdhjetëmujore, që fillon ose përfundon në vitin fiskal përkatës;

b) kryerjen e shërbimeve, përfshirë shërbimet e konsulencës nga një sipërmarrje nëpërmjet të punësuarve ose edhe personeli tjetër të zënë me punë, nga sipërmarrja për këtë qëllim, por vetëm kur aktivitete të kësaj natyre vazhdojnë brenda vendit për një periudhë ose periudha që në total i kalojnë tre muaj brenda çdo periudhe dymbëdhjetëmujore, që fillon ose përfundon në vitin fiskal përkatës.

4. Pavarësisht nga dispozitat e mëparshme të këtij neni termi “seli e përhershme” nuk do të përfshijë:

a) përdorimin e pajisjeve ose objekteve vetëm për qëllime magazinimi ose ekspozimi të mallrave që i përkasin sipërmarrjes;

b) mbajtjen e një gjendjeje mallrash që i përkasin sipërmarrjes vetëm për qëllime magazinimi ose ekspozimi;

c) mbajtjen e një gjendjeje mallrash që i përkasin sipërmarrjes vetëm për qëllime përpunimi nga një sipërmarrje tjetër;

d) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm me qëllim blerjen e mallrave ose për mbledhje informacioni për sipërmarrjen;

e) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për qëllim të ushtrimit, për sipërmarrjen, të çdo aktiviteti tjetër me karakter përgatitor ose ndihmës.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, kur një person, i ndryshëm nga një agjent me status të pavarur, ndaj të cilit zbatohet paragrafi, vepron në një Shtet Kontraktues në emër të një sipërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues, kjo sipërmarrje do të konsiderohet se ka një seli të përhershme në Shtetin Kontraktues të përmendur në fillim lidhur me çdo aktivitet që ai person ndërmerr për sipërmarrjen, në qoftë se ky person:

a) ka dhe zakonisht e ushtron në shtetin e përmendur në fillim një autoritet për të përfunduar kontrata në emër të sipërmarrjes, përveç kur aktivitetet e këtyre personave kufizohen në ato të përmendura në paragrafin 4, të cilat, edhe pse ushtrohen nëpërmjet një vendi fiks biznesi, nuk e bëjnë këtë vend fiks biznesi një seli të përhershme sipas dispozitave të atij paragrafi;

b) nuk ka një autoritet të tillë, por zakonisht mban në shtetin e përmendur në fillim një gjendje mallrash, nga i cila ai shpërndan rregullisht mallra në emër të sipërmarrjes.

6. Një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues nuk do të konsiderohet se ka një seli të përhershme në Shtetin tjetër Kontraktues vetëm për faktin se ajo ushtron biznes në këtë shtet tjetër nëpërmjet një ndërmjetësi, komisioneri të përgjithshëm apo çdo lloj agjenti tjetër me një status të pavarur, me kusht që të tillë persona veprojnë brenda kuadrit të zakonshëm të aktivitetit të tyre. Sidoqoftë, kur aktivitetet e një agjenti të tillë kryhen tërësisht ose pothuajse tërësisht në emër të asaj sipërmarrjeje, ai nuk do të konsiderohet një agjent me një status të pavarur brenda kuptimit të këtij paragrafi.

7. Pavarësisht nga dispozitat e mëparshme të këtij neni, një sipërmarrje sigurimi e një Shteti Kontraktues, do të konsiderohet, me përjashtim të aktivitetit të risigurimit, se ka seli të përhershme në Shtetin tjetër Kontraktues, nëse mbledh prime në territorin e këtij shteti tjetër ose siguron nga rreziqet atje nëpërmjet një personi të ndryshëm nga një agjent me status të pavarur, ndaj të cilit aplikohet paragrafi 6.

8. Fakti që një shoqëri që është rezidente e një Shteti Kontraktues kontrollon ose kontrollohet nga një shoqëri që është rezidente e Shtetit tjetër Kontraktues ose që ushtron aktivitet në atë Shtet tjetër (nëpërmjet një selie të përhershme ose në forma të tjera) nuk përbën në vetvete arsye të mjaftueshme për të konsideruar njërën shoqëri seli të përhershme të tjetrës.

Neni 6

Të ardhurat nga pasuria e paluajtshme

1. Të ardhurat e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga pasuri të paluajtshme (përfshirë të ardhurat nga bujqësia dhe pyjet) të vendosura në Shtetin tjetër Kontraktues mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

2. Termi “pasuri e paluajtshme” do të ketë kuptimin që ka sipas ligjit të Shtetit Kontraktues ku është vendosur prona në fjalë. Në çdo rast ky term do të përfshijë pasuritë aksesore të pasurisë së paluajtshme, inventarin e gjallë dhe pajisjet e përdorura në bujqësi e në pyje, të drejtat ndaj të cilave zbatohen dispozitat e legjislacionit të përgjithshëm lidhur me pronën mbi tokë, uzufrukti i pasurive të paluajtshme dhe të drejtat ndaj pagesave fikse ose variabël për shfrytëzimin ose të drejtën për të shfrytëzuar vendburimet minerare dhe burime e pasuri të tjera natyrore. Anijet dhe avionët nuk konsiderohen pasuri të paluajtshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohen ndaj të ardhurave të realizuara nga përdorimi direkt, dhënia me qira ose përdorimi në çdo formë tjetër i pasurive të paluajtshme.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 3 do të zbatohen gjithashtu ndaj të ardhurave nga pasuria e paluajtshme e një sipërmarrjeje dhe ndaj të ardhurave nga pasuria e paluajtshme e përdorur për kryerjen e shërbimeve personale të pavarura.

Neni 7

Fitimet nga biznesi

1. Fitimet e një sipërmarrjeje të një Shteti Kontraktues do të takohen vetëm në atë shtet, përveç kur sipërmarrja ushtron aktivitet në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty. Në qoftë se sipërmarrja ushtron aktivitetin në mënyrën e sipërpërmendur, fitimet e sipërmarrjes mund të tatohen në shtetin tjetër, por vetëm ajo pjesë e tyre që i atribuohet:

a) asaj selie të përhershme;

b) shitjeve në atë shtet tjetër të mallrave njëlloj ose në mënyrë të ngjashme si shitjet nëpërmjet selisë së përhershme;

c) aktiviteteve të tjera të biznesit të ushtruara në këtë shtet tjetër njëlloj ose në mënyrë të ngjashme me ato të ushtruara nëpërmjet kësaj selie të përhershme.

2. Pa cenuar dispozitat e paragrafit 3, kur një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, atëherë në secilin Shtet Kontraktues, selisë së përhershme do t'i atribuohen fitimet që ajo do të realizonte, nëse ajo do të ishte një sipërmarrje e veçantë dhe e pavarur, që do të vepronte në të njëjtin ose në aktivitete të ngjashme në kushte të njëjta ose të ngjashme dhe tërësisht e pavarur nga sipërmarrja, seli e përhershme e së cilës ajo është.

3. Në përcaktimin e fitimeve të një selie të përhershme, do të lejohet zbritja e shpenzimeve që janë kryer për qëllimet e aktivitetit të selisë së përhershme, përfshirë shpenzimet e përgjithshme administrative dhe ekzekutive si në shtetin ku ndodhet selia e përhershme, ashtu edhe gjetkë. Megjithatë, nuk do të trajtohen si shpenzime të zbritshme shumat, nëse ka, të paguara (përveç atyre për rimbursime të shpenzimeve të kryera) nga një seli e përhershme për zyrën qendrore të sipërmarrjes apo për ndonjë zyrë tjetër të saj, si honorare apo pagesa të tjera të ngjashme si shpërblim për përdorim patentash apo të drejta të tjera, ose si komisione për shërbime të veçanta të kryera për menaxhim, ose përveç rastit të sipërmarrjeve bankare, si interesa të huave dhënë selisë së përhershme. Në të njëjtën mënyrë, nuk do të merren parasysh në përcaktimin e fitimeve të selisë së përhershme, për shuma të ngarkuara (përveç atyre për rimbursime të shpenzimeve të kyera) nga ana e selisë së përhershme për zyrën qendrore të sipërmarrjes apo për ndonjë zyrë tjetër të saj, si honorare apo pagesa të tjera të ngjashme si shpërblim për përdorim patentash apo të drejta të tjera, ose si komisione për shërbime të veçanta të kryera apo për menaxhim, ose, përveç ratit të sipërmarrjeve bankare, si interesa të huave dhënë zyrës qendrore të sipërmarrjes ose ndonjë zyre tjetër të saj.

4. Përderisa në njërin prej Shteteve Kontraktuese përcaktimi i fitimeve që i atribuohen një selie të përhershme bëhet zakonisht me metodën e ndarjes së fitimeve të përgjithshme të sipërmarrjes midis pjesëve të veçanta të saj, dispozitat e paragrafit 2 nuk e pengojnë atë Shtet Kontraktues të përcaktojë fitimet e tatueshme në bazë të kësaj metode, siç bëhet zakonisht, megjithatë rezultati i kësaj metode duhet të jetë konform parimeve që përmban ky nen.

5. Asnjë fitim nuk do t'i atribuohet një selie të përhershme vetëm për faktin se ajo blen mallra nëpërmjet kësaj selie të përhershme për sipërmarrjen.

6. Për qëllimet e paragrafëve të mësipërm, fitimet që do t'i atribuohen selisë së përhershme do të përcaktohen me të njëjtën metodë çdo vit, përderisa të mos ketë arsye të forta dhe të mjaftueshme për të proceduar ndryshe.

7. Kur fitimet përmbajnë elemente të të ardhurave që trajtohen veças në nene të tjera të kësaj Konvente, atëhere dispozitat e atyre neneve nuk do të ndikohen nga dispozitat e këtij neni.

Neni 8
Transporti ndërkombëtar

1. Fitimet e një sipërmarrjeje të një Shteti Kontraktues nga veprimtaria e anijeve ose avionëve në trafikun ndërkombëtar do të tatohen vetëm në atë shtet.

2. Dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohen gjithashtu ndaj fitimeve nga pjesëmarrja në një ortakëri, një biznes të përbashkët ose në një agjenci ndërkombëtare transporti.

Neni 9
Sipërmarrje të lidhura

1. Kur:

a) një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues merr pjesë direkt ose indirekt në drejtimin, kontrollin ose kapitalin e një sipërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues ose

b) të njëjtët persona marrin pjesë direkt ose indirekt në drejtimin, kontrollin apo kapitalin e një sipërmarrjeje të një Shteti Kontraktues dhe të një sipërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues,

dhe në secilin rast kushtet që janë pranuar ose që janë vendosur midis dy sipërmarrjeve në

marrëdhëniet e tyre tregtare ose financiare ndryshojnë nga ato që do të vendoseshin midis sipërmarrjeve të pavarura, atëherë çdo fitim që duhej të realizohej nga njëra sipërmarrje, por, për shkak të këtyre kushteve nuk është realizuar, mund të përfshihet në fitimet e asaj sipërmarrjeje dhe të tatohet normalisht.

2. Kur një Shtet Kontraktues përfshin në fitimet e një sipërmarrje të atij shteti, dhe i taton normalisht, fitime mbi të cilat një sipërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues është ngarkuar me tatim në atë shtet tjetër dhe fitimet e përfshira në këtë mënyrë janë fitime që do të ishin realizuar nga sipërmarrja e shtetit të përmendur në fillim, nëse kushtet e vendosura ndërmjet dy sipërmarrjeve do të ishin ato që do të vendoseshin ndërmjet sipërmarrjeve të pavarura, atëherë ai shtet tjetër do të bëjë rregullimin e duhur në shumën e tatimit të ngarkuar në atë shtet mbi ato fitime, kur ai shtet tjetër e konsideron të justifikuar rregullimin. Në përcaktimin e rregullimeve të tilla, do të respektohen edhe dispozitat e tjera të kësaj Konvente dhe autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese, në rast nevoje, do të konsultohen me njëri-tjetrin.

Neni 10
Dividentët

1. Dividentët e paguar nga një shoqëri, që është rezidente e një Shteti Kontraktues, një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohen në atë shtet tjetër.

2. Megjithatë, këto dividentë mund të tatohen edhe në Shtetin Kontraktues, rezidente e të cilit është kompania paguese e dividentëve dhe në përputhje me ligjet e këtij shteti, por, nëse pronari përfitues i dividentëve është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, tatimi i ngarkuar nuk do të kalojë:

a) 5 për qind të shumës bruto të dividentëve, nëse pronari përfitues është një shoqëri (joortakëri) që zotëron direkt të paktën 25 për qind të kapitalit të shoqërisë paguese të dividentëve;

b) 10 për qind të shumës bruto të dividentëve, në të gjitha rastet e tjera.

Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të vendosin me mirëkuptim reciprok mënyrën e zbatimit të këtyre kufizimeve.

Ky paragraf nuk do të ketë efekt mbi tatimin e shoqërisë lidhur me fitimet prej të cilave janë paguar dividentët.

3. Termi “dividentë” në përdorimin në këtë nen nënkupton të ardhurat nga aksionet e çdo lloji apo të drejta të tjera që nuk janë kërkesa borxhi, pjesëmarrja në fitime, si edhe të ardhura nga të drejta të tjera të shoqërisë, që i nënshtrohen të njëjtit trajtim tatimor si të ardhurat nga aksionet nga ligjet e shtetit, rezidente e të cilit është shoqëria që bën shpërndarjen e dividentëve.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen nëse pronari përfitues i dividentëve, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues, rezidente e të cilit është kompania paguese e dividentëve, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty ose ushtron në këtë Shtet shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur atje dhe zotërimi, lidhur me të cilin janë paguar dividentët, është efektivisht i lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 14, sipas rastit.

5. Kur një shoqëri që është rezidente e një Shteti Kontraktues realizon fitime ose të ardhura nga Shteti tjetër Kontraktues, ky shtet tjetër mund të mos aplikojë tatim mbi dividentët e paguar nga shoqëria, përveç kur këto dividentë i paguhen një rezidenti të shtetit tjetër ose kur zotërimi, lidhur me të cilin janë paguar dividentët, është efektivisht i lidhur me një seli të përhershme ose bazë fikse të vendosur në këtë shtet tjetër, gjithashtu subjekt i tatimit mbi fitimet e pashpërndara të shoqërisë nuk janë as fitimet e pashpërndara të shoqërisë, edhe sikur dividentët e paguar ose fitimet e pashpërndara konsistojnë tërësisht ose pjesërisht si fitime apo të ardhura të realizuara në këtë shtet tjetër.

Neni 11
Interesat

1. Interesat që krijohen në një Shtet Kontraktues dhe i paguhen një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohen në atë shtet tjetër.

2. Megjithatë, këto interesa mund të tatohen edhe në Shtetin Kontraktues ku ato krijohen dhe në përputhje me ligjet e atij shteti, por, nëse pronari përfitues i interesave është një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, tatimi i zbatuar nuk duhet të kalojë 5 për qind të shumës bruto të interesit.

Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të zgjidhin me mirëkuptim reciprok mënyrën e zbatimit të këtij kufizimi.

3. Termi "interesa" në kuptimin e përdorur në këtë nen nënkupton të ardhurat nga kërkesat e borxhit të çdo lloji, të siguruara ose jo me hipotekim dhe që e kanë ose jo të drejtën e pjesëmarrjes në fitimet e debitorit dhe në veçanti të ardhurat nga obligacionet qeveritare dhe të ardhurat nga letrat me vlerë ose huatë, duke përfshirë fitimet dhe çmimet e lidhura me këto obligacione, letra me vlerë ose hua. Gjobat e ngarkuara për pagesat e vonuara nuk do të trajtohen si interesa për qëllime të këtij neni.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen në qoftë se pronari përfitues i interesave, duke qenë një rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues ku krijohen interesat, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, ose ushtron në këtë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur atje dhe kërkesa e huasë lidhur me të cilën paguhet interesi është efektivisht e lidhur me: a) këtë seli të përhershme apo bazë fikse ose me b) aktivitete biznesi që i referohen nënparagrafit (c) të paragrafit 1 të nenit 7. Në këto raste do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 14, sipas rastit.

5. Interesat do të konsiderohen se krijohen në një Shtet Kontraktues kur pagues është një rezident i atij shteti. Megjithatë, kur personi që paguan interesat, qoftë ose jo rezident i njërit Shtet Kontraktues, ka në një Shtet Kontraktues një seli të përhershme ose bazë fikse në lidhje me të cilën ka lindur huaja për të cilën paguhet interesi dhe këto interesa krijohen nga selia e përhershme ose baza fikse, atëherë këto interesa do të konsiderohen se janë krijuar në shtetin ku është vendosur selia e përhershme ose baza fikse.

6. Kur për shkak të lidhjeve të veçanta ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues të interesave ose ndërmjet të dyve dhe personave të tretë, shuma e interesave, bazuar në kërkesën e borxhit për të cilën ato paguhen, e kalon shumën mbi të cilën duhej të ishte rënë dakord ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues në mungesë të lidhjeve të tilla të veçanta, dispozitat e këtij neni do të zbatohen vetëm mbi shumën e përmendur në fund. Në këtë rast, pjesa që kalon pagesën normale do të mbetet e tatueshme në përputhje me ligjet e secilit Shtet Kontraktues, duke pasur parasysh edhe dispozitat e tjera të kësaj Konvente.

Neni 12
Honoraret

1. Honoraret që krijohen në një Shtet Kontraktues dhe i paguhen një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohen në atë shtet tjetër.

2. Megjithatë, këto të ardhura mund të tatohen gjithashtu në Shtetin Kontraktues ku krijohen dhe në përputhje me ligjet e këtij shteti, por nëse pronari përfitues i honorareve është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, tatimi i ngarkuar nuk duhet të kalojë 10 për qind të shumës bruto të honorarit.

Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të vendosin me mirëkuptim reciprok për mënyrën e zbatimit të këtij kufizimi.

3. Termi "honorare" nën dispozitat e këtij neni nënkupton pagesat e çdo lloji të marra si shpërblim për përdorimin ose të drejtën e përdorimit të së drejtës së autorit për punimet letrare, artistike ose shkencore, përfshirë filmat kinematografikë dhe filmat e kasetat për transmetime radio-televizive, çdo patentë, programe kompjuterike, markë tregtare, skicë ose model, plan, proces ose formulë sekrete, ose për informacione lidhur me eksperiencën industriale tregtare ose shkencore.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni nuk do të zbatohen nëse pronari përfitues i honorareve, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues ku krijohen honoraret, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, ose kryen në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosur aty, dhe e drejta ose prona për të cilën paguhen honoraret është efektivisht e lidhur me: a) këtë seli të përhershme ose bazë fikse ose b) aktivitete biznesi që i referohen nënparagrafit (c) të paragrafit 1 të nenit 7. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 14, sipas rastit.

5. Honoraret do të konsiderohen se krijohen në një Shtet Kontraktues kur pagues është një rezident i atij shteti. Megjithatë, kur personi që paguan honoraret, qoftë ose jo rezident i një Shteti Kontraktues, ka në njërin Shtet Kontraktues një seli të përhershme ose një bazë fikse, në lidhje me të cilën ka lindur e drejta e pagimit të honorareve dhe këto honorare kanë lindur nga kjo seli e

përhershme ose bazë fikse, atëherë këto honorare do të konsiderohen se kanë lindur në Shtetin Kontraktues ku ndodhet selia e përhershme ose baza fikse.

6. Kur për shkak të lidhjeve të veçanta ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues të honorareve ose midis të dyve dhe personave të tretë, shuma e honorareve, duke pasur parasysh përdorimin, të drejtën apo informacionin për të cilin ato janë paguar, e kalon shumën për të cilën do të ishte rënë dakord ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues në mungesë të marrëdhënieve të tilla, atëherë dispozitat e këtij neni do të zbatohen vetëm mbi shumën e përmendur në fund. Në një rast të tillë pjesa e shpërblimit që kalon shpërblimin normal mbetet e tatueshme sipas ligjeve përkatëse të secilit Shtet Kontraktues, duke pasur parasysh dispozitat e tjera të kësaj Konvente.

Neni 13
Fitimet nga kapitali

1. Fitimet e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga tjetërsimi i pasurive të paluajtshme që i referohen nenit 6 dhe të vendosura në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

2. Fitimet nga tjetërsimi i pasurive të paluajtshme që bëjnë pjesë në pasuritë e bisnesit të një selie të përhershme, që një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues ose pasurive të luajtshme që i përkasin një baze fikse që një rezident i një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues për të kryer shërbime personale të pavarura, përfshirë edhe fitimet nga tjetërsimi i vetë selisë së përhershme (vetëm ose bashkë me sipërmarrjen) ose i bazës fikse, mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

3. Fitimet e realizuara nga një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues nga tjetërsimi i anijeve ose avionëve, që veprojnë në trafikun ndërkombëtar ose i pasurive të luajtshme që i përkasin veprimtarisë së këtyre anijeve ose avionëve do të tatohen vetëm në atë shtet.

4. Fitimet nga tjetërsimi i aksioneve të kapitalit të një shoqërie ose i pjesëmarrjes në një ortakëri ose kompani, pasuria e së cilës konsiston direkt ose indirekt kryesisht në pasuri të paluajtshme të vendosura në një Shtet Kontraktues, mund të tatohen në atë Shtet Kontraktues.

5. Fitimet nga tjetërsimi i çdo pasurie që nuk mbulohet nga paragrafët e mësipërm të këtij neni, do të tatohen vetëm në Shtetin Kontraktues, rezident i të cilit është tjetërsuesi.

Neni 14
Shërbimet personale të pavarura

1. Të ardhurat e realizuara nga një individ që është rezident i një Shteti Kontraktues lidhur me shërbimet profesionale ose shërbime të tjera të ngjashme të një karakteri të pavarur do të tatohen vetëm në atë shtet, përveç në rrethanat që vijojnë, kur këto të ardhura mund të tatohen gjithashtu në Shtetin tjetër Kontraktues:

a) kur ai ka një bazë fikse në dispozicion të tij në Shtetin tjetër Kontraktues që rregullisht i shërben atij për të kryer aktivitetet e tij; në këtë rast, vetëm ajo pjesë e të ardhurave që i atribuohet kësaj baze fikse mund të tatohet në këtë shtet tjetër;

b) nëse qëndrimi i tij në Shtetin tjetër Kontraktues është për një periudhë ose periudha që në total arrijnë ose i kalojnë 183 ditë në çdo periudhë dymbëdhjetëmujore që fillon ose përfundon në vitin përkatës fiskal; në këtë rast, vetëm ajo pjesë e të ardhurave e realizuar nga aktivitetet e tij të kryera në këtë Shtet tjetër mund të tatohen në këtë Shtet tjetër.

2. Termi “shërbime profesionale” përfshin në veçanti aktivitetet e pavarura shkencore, letrare, artistike, arsimore apo të mësimdhënies, si dhe aktivitetet e pavarura të mjekëve, dentistëve, avokatëve, inxhinierëve, arkitektëve, llogaritarëve, kontrollorëve dhe këshilltarëve.

Neni 15
Të ardhurat nga punësimi

1. Pa cenuar dispozitat e neneve 16, 18 dhe 19, pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme, që përfitohen nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga punësimi i tij do të tatohen vetëm në këtë shtet, përveç kur puna është ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues. Nëse puna ushtrohet në këtë

mënyrë, atëherë këto të ardhura mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, të ardhurat e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues lidhur me punën e ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues do të tatohen vetëm në shtetin e përmendur në fillim në qoftë se:

a) përfituesi është prezent në shtetin tjetër për një periudhë ose periudha që nuk i kalojnë në total 183 ditë në çdo periudhë dymbëdhjetë mujore që fillon ose përfundon në vitin fiskal përkatës;

b) shpërblimi paguhet nga, ose në emër të një punëdhënësi që nuk është rezident i shtetit tjetër;

c) shpërblimi nuk ka lindur nga një seli e përhershme ose bazë fikse që punëdhënësi ka në shtetin tjetër.

3. Pavarësisht nga dispozitat e mëparshme të këtij neni, shpërblimet e përfituara lidhur me punën e ushtruar në bordin e një anije ose avioni që operon në trafikun ndërkombëtar nga një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues mund të tatohen në këtë shtet.

Neni 16
Shpërblimet e drejtorëve

Shpërblimet e drejtorëve dhe pagesa të tjera të ngjashme të realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues në pozitën e tij si anëtar i bordit të drejtorëve ose çdo organi të ngjashëm të një shoqërie që është rezidente e Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

Neni 17
Artistët dhe sportistët

1. Pavarësisht nga dispozitat e neneve 14 dhe 15 të ardhurat e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues si një artist, si aktor teatri, kinematografie, radiotelevizioni, si muzikant ose sportist, nga aktivitetet e tij personale si të tilla, të ushtruara në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

2. Kur të ardhurat lidhur me aktivitetet personale të ushtruara nga një artist ose sportist në pozitën e tij si i tillë që nuk realizohen direkt nga sportisti ose artisti, por nga një person tjetër, këto të ardhura, pavarësisht nga dispozitat e neneve 7, 14 dhe 15, mund të tatohen në Shtetin Kontraktues, në të cilin janë ushtruar aktivitetet e artistit ose sportistit.

Neni 18
Pensionet

Pa cenuar dispozitat e paragrafit 2 të nenit 19, pensionet dhe shpërblime të tjera të ngjashme paguar një rezidenti të një Shteti Kontraktues, lidhur me punësimin e tij në të kaluarën, do të tatohen vetëm në atë shtet.

Neni 19
Shërbimet qeveritare

1. a) Rrogat dhe pagat, si edhe shpërblime të tjera të ngjashme të ndryshme nga pensionet, të paguara nga një Shtet Kontraktues, njësi administrativo-territoriale ose nga një autoritet lokal atje, një individi lidhur me shërbimet e kryera atij shteti, njësie ose autoriteti do të tatohen vetëm në atë shtet.

b) Megjithatë, këto rroga, paga dhe shpërblime të tjera të ngjashme do të tatohen vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues, nëse shërbimet janë kryer në atë shtet dhe individi është rezident i atij shteti, i cili:

i) është nënshtetas i atij shteti;

ii) nuk është bërë rezident i atij shteti vetëm për qëllim të kryerjes së shërbimeve.

2. a) Çdo pension i paguar nga, ose prej fondeve të krijuara nga një Shtet Kontraktues, njësi territoriale-administrative ose autoritet lokal atje një individi lidhur me shërbimet e kryera atij Shteti, njësie ose autoriteti do të tatohen vetëm në atë shtet.

b) Megjithatë, këto pensione do të tatohen vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues, nëse individi

është rezident dhe nënshtetas i këtij shteti.

3. Dispozitat e neneve 15, 16 dhe 18 do të zbatohen mbi rrogat, pagat, si edhe shpërblime të tjera të ngjashme dhe mbi pensionet, lidhur me shërbimet e kryera lidhur me një aktivitet biznesi të ushtruar nga një Shtet Kontraktues, njësi administrativo-territoriale ose një autoritet lokal atje.

Neni 20
Studentët

Një student ose specializant që është ose ishte rezident i një Shteti Kontraktues menjëherë përpara vajtjes në Shtetin tjetër Kontraktues dhe që është prezent në Shtetin tjetër Kontraktues vetëm për qëllim të arsimimit ose trajnimit të tij, për pagesat që merr për qëllim të jetesës, shkollimit ose trajnimit nuk do të tatohet në këtë shtet tjetër, me kusht që këto pagesa të kryhen nga burime jashtë këtij shteti.

Neni 21
Të ardhura të tjera

1. Lloje të të ardhurave të një rezidenti të një Shteti Kontraktues, kudo që të krijohen, që nuk lidhen me nenet e mëparshëm të kësaj Konvente, do të tatohen vetëm në atë shtet.

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk do të zbatohen ndaj të ardhurave, të ndryshme nga të ardhurat nga pasuria e paluajtshme të përcaktuara në paragrafin 2 të nenit 6, nëse përfituesi i këtyre të ardhurave, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron aktivitet në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, ose kryen në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur aty, dhe e drejta ose pasuria lidhur me të cilën paguhet shpërblimi është efektivisht e lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose 14 sipas rastit.

Neni 22
Kapitali

1. Kapitali i përfaqësuar nga pasuri të paluajtshme të referuara në nenin 6, të zotëruara nga një rezident i një Shteti Kontraktues dhe të vendosura në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

2. Kapitali i përfaqësuar nga pasuri të luajtshme, që bëjnë pjesë në pasurinë biznesore të një selie të përhershme që një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues ose nga pasuri të luajtshme që i përkasin një baze fikse në dispozicion të një rezidenti të një Shteti Kontraktues në Shtetin tjetër Kontraktues për kryerjen e shërbimeve personale të pavarura, mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

3. Kapitali i përfaqësuar nga anije dhe avionë, që operohen nga një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues në trafikun ndërkombëtar, si dhe nga pasuritë e luajtshme që i përkasin aktivitetit të këtyre anijeve dhe avionëve do të tatohen vetëm në këtë shtet.

4. Të gjitha elementet e tjera të kapitalit të një rezidenti të një Shteti Kontraktues do të tatohen vetëm në atë shtet.

Neni 23
Eliminimi i tatimit të dyfishtë

1. Kur një rezident i një Shteti Kontraktues realizon të ardhura ose zotëron kapitale të cilat, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, mund të tatohen në Shtetin tjetër Kontraktues, shteti i përmendur në fillim do të lejojë:

a) një reduktim nga tatimi mbi të ardhurat e atij rezidenti, të një shume të barabartë me tatimin mbi të ardhurat të paguara në atë shtet tjetër;

b) një reduktim nga tatimi mbi kapitalin e atij rezidenti, të një shume të barabartë me tatimin mbi kapitalin të paguar në atë shtet tjetër.

Megjithatë, në secilin rast, ky reduktim nuk do të kalojë atë pjesë të tatimit mbi të ardhurat ose

kapitalin e llogaritur para dhënies së reduktimit, që i atribuohet, sipas rastit, të ardhurave ose kapitalit që mund të tatohen në atë shtet tjetër.

2. Kur në përputhje me dispozitat e Konventës, të ardhurat e realizuara ose kapitali i zotëruar nga një rezident i një Shteti Kontraktues përjashtohen nga tatimi në atë shtet, megjithatë, në llogaritjen e shumës së tatimit mbi të ardhurat ose kapitalin e mbetur të këtij rezidenti, ai shtet merr parasysh të ardhurat ose kapitalin e përjashtuar.

Neni 24
Mosdiskriminimi

1. Nënshtetasit e një Shteti Kontraktues nuk do të jenë në Shtetin tjetër Kontraktues subjekt i ndonjë tatimi ose kërkese të lidhur me të, që të jetë i ndryshëm ose më i rëndë se sa tatimi ose kërkesat e lidhura me të, të cilave i nënshtrohen nënshtetasit e këtij shteti tjetër në rrethana të njëjta, në veçanti lidhur me rezidencën. Kjo dispozitë, pavarësisht nga dispozitat e nenit 1, do të zbatohet gjithashtu ndaj personave që nuk janë rezidentë të njërit ose të asnjërit prej Shteteve Kontraktuese.

2. Tatimi i një selie të përhershme që një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues nuk do të jetë më pak i favorshëm në këtë shtet tjetër, sesa tatimi i ngarkuar ndaj sipërmarrjeve të këtij shteti tjetër që ushtrojnë aktivitete të njëjta. Kjo dispozitë nuk do të merret si detyrim i njërit Shtet Kontraktues për t'u garantuar rezidentëve të Shtetit tjetër Kontraktues lehtësime personale dhe reduktime tatimore që i garanton rezidentëve të shtetit të vet, për shkak të gjendjes civile dhe përgjegjësive familjare që ata kanë.

3. Përjashtuar rastet kur zbatohen dispozitat e paragrafit 1 të nenit 9, paragrafit 6 të nenit 11, ose paragrafit 6 të nenit 12, interesat, honoraret dhe shpërblime të tjera të paguara nga një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, për efekt të përcaktimit të fitimeve të tatueshme të kësaj sipërmarrjeje, do të jenë të reduktueshme nën të njëjtat kushte njëlloj sikur ato t'i paguheshin një rezidenti të shtetit të përmendur në fillim. Në mënyrë të ngjashme, çdo borxh i një sipërmarrjeje të një Shteti Kontraktues ndaj një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, për efekt të përcaktimit të kapitalit të tatueshëm të kësaj sipërmarrjeje, do të jetë i reduktueshëm nën të njëjtat kushte njëlloj sikur sipërmarrja të kishte kontraktuar me një rezident të shtetit të përmendur në fillim.

4. Sipërmarrjet e një Shteti Kontraktues, kapitali i të cilave është totalisht ose pjesërisht i zotëruar ose kontrolluar direkt ose indirekt nga një ose më shumë rezidentë të Shtetit tjetër Kontraktues, nuk do të jenë në shtetin e përmendur në fillim subjekt i ndonjë tatimi ose kërkese të lidhur me të, që të jetë tjetër ose më i rëndë sesa tatimi ose kërkesat e lidhura me të, të cilave i nënshtrohen sipërmarrje të tjera të ngjashme të shtetit të përmendur në fillim.

Neni 25
Procedura e mirëkuptimit reciprok

1. Kur një person mendon se veprimet e njërit ose e të dy Shteteve Kontraktuese e rëndojnë ose do ta rëndojnë atë me tatime që nuk janë në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, pavarësisht nga mënyra e ankimit të parashikuara në legjislacionin e brendshëm të këtyre shteteve, ai mund t'ua paraqesë rastin e tij autoriteteve kompetente të Shtetit Kontraktues, rezident i të cilit ai është, ose nëse rasti lidhet me paragrafin 1 të nenit 24, ai mund t'ia paraqesë atë Shtetit Kontraktues, nënshtetas i të cilit ai është. Çështja duhet të paraqitet brenda tre vjetëve nga njoftimi i parë lidhur me tatimin që nuk është në përputhje me dispozitat e Konventës.

2. Autoriteti kompetent, nëse kërkesa i duket e justifikuar dhe ai vetë nuk e ka të mundur arritjen e një zgjidhje të kënaqshme, do të përpiqet ta zgjidhë çështjen me mirëkuptim reciprok me autoritetin kompetent të Shtetit tjetër Kontraktues, me synim shmangien e tatimit që nuk është në përputhje me Konventën. Çdo marrëveshje e arritur do të zbatohet pavarësisht nga kufijtë kohorë që mund të parashikojë legjislacioni i brendshëm i Shteteve Kontraktuese.

3. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të përpiqen që me mirëkuptim reciprok të zgjidhin çdo vështirësi ose dyshim që lind nga interpretimi ose zbatimi i Konventës. Ato gjithashtu mund të konsultohen së bashku për eliminimin e tatimit të dyfishtë në rastet kur një gjë e tillë nuk parashikohet nga Konventa.

4. Autoritet kompetente të Shteteve Kontraktuese mund të komunikojnë me njëri-tjetrin direkt,

përfshirë edhe takimet nëpërmjet komisioneve të përbashkëta të përbëra prej tyre ose përfaqësuesve të tyre, për arritjen e mirëkuptimit në kuptimin e paragrafëve të mësipërm.

Neni 26
Shkëmbimi i informacionit

1. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të shkëmbejnë informacionet e nevojshme për zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente ose të ligjeve të brendshme të Shteteve Kontraktuese lidhur me tatimet që mbulon Konventa, përderisa ato tatime nuk janë në kundërshtim me Konventën. Shkëmbimi i informacionit nuk kufizohet nga nenet 1 dhe 2 të kësaj Konvente. Çdo informacion i marrë nga një Shtet Kontraktues do të trajtohet si sekret, në të njëjtën mënyrë si informacioni i marrë nën legjislacionin e brendshëm të atij shteti dhe do t'u serviret vetëm personave ose autoriteteve (përfshirë gjykatat dhe organet administrative) të përfshira në llogaritjen ose mbledhjen e tatimeve, me imponimin ose ndjekjet lidhur me shkeljet tatimore ose lidhur me ankesat ndaj tatimeve që mbulon Konventa. Këto persona ose autoritete do ta përdorin informacionin vetëm për të tilla qëllime. Ato mund ta servirin informacionin në procedurat ose vendimet gjyqësore.

2. Në asnjë rast dispozitat e paragrafit 1 nuk do të interpretohen në kuptimin që i imponojnë njërit prej Shteteve Kontraktuese detyrimin:

a) të zbatojnë masa administrative në ndryshim me ligjet dhe praktikat administrative të atij ose të Shtetit tjetër Kontraktues;

b) të japë informacione që ndalohen sipas ligjeve dhe praktikës normale administrative të atij ose të Shtetit tjetër Kontraktues;

c) të japë informacione që mund të nxirrnin një sekret tregtar, biznesor, industrial, komercial ose profesional apo informacione, komunikimi i të cilave do të ishte në kundërshtim me politikën publike (rendin publik).

Neni 27
Funksionarët e misioneve diplomatike dhe konsullore

Dispozitat e kësaj Konvente nuk cenojnë privilegjet fiskale të funksionarëve diplomatikë dhe konsullorë që rrjedhin nga rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare apo nga dispozita të marrëveshjeve të veçanta.

Neni 28
Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi në datën e njoftimit me shkrim, më të vonshëm, nëpërmjet kanaleve diplomatike, i cili konfirmon plotësimin nga Shtetet Kontraktuese të procedurave të kërkuara prej ligjeve të tyre për hyrjen në fuqi të Konventës dhe dispozitat e saj do të kenë efekt:

a) lidhur me tatimet e mbajtura në burim, mbi të ardhurat e realizuara më ose pas 1 janarit të vitit kalendarik që pason vitin në të cilin kjo Konventë hyn në fuqi;

b) lidhur me tatimet e tjera mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin, ndaj tatimeve të pagueshme për çdo vit kalendarik që fillon më ose pas 1 janarit të vitit kalendarik që pason vitin në të cilin Konventa hyn në fuqi.

Neni 29
Përfundimi

Kjo Konventë do të mbetet në fuqi deri në përfundimin nga njëri Shtet Kontraktues. Secili Shtet Kontraktues mund të përfundojë Konventën nëpërmjet kanaleve diplomatike, duke dhënë njoftimin me shkrim të përfundimit të paktën gjashtë muaj përpara përfundimit të çdo viti kalendarik, që fillon pas mbarimit të një periudhe pesë-vjeçare nga data e hyrjes në fuqi të Konventës. Në rast të tillë, Konventa do të pushojë së pasuri efekt:

a) lidhur me tatimet e mbajtura në burim, mbi të ardhurat e realizuara më ose pas 1 janarit të vitit tjetër kalendarik që ndjek vitin në të cilin është dhënë njoftimi i përfundimit;

b) lidhur me tatimet e tjera mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin, për çdo vit tatimor që fillon më 1 janar të vitit tjetër kalendarik që ndjek vitin në të cilin është dhënë njoftimi i përfundimit.

Nënshkruesit, në praninë dhe të autorizuar në mënyrën e duhur, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Porto/Portugali, më 6 dhjetor 2002, në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe, moldave dhe angleze, të dy tekstet origjinale kanë vlera të barabarta. Në raste kontradiktash midis teksteve, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PROTOKOLL

Në momentin e nënshkrimit të Konventës midis Qeverisë së Republikës së Moldavisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin, nënshkruesit ranë dakord se dispozitat e mëposhtëme do të jenë pjesë përbërëse e kësaj Konvente.

Termi “kapitali” do të përfshijë pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme si dhe çdo lloj tjetër pasurie, sipas ligjeve tatimore të Shtetit Kontraktues në të cilin këto pasuri janë vendosur.

Nënshkruesit, në praninë dhe të autorizuar në mënyrën e duhur, kanë nënshkruar këtë Protokoll.